

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 28724/25

Nr. i fq. / Br. st. -2-

Data: / Datum: 25.06.25

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 111/25, 25/06/2025

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 27 maj 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:45.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Kushtrim Hyseni, Zojë Hajrizi, Behar Duraku, Gresa Muli, Zana Krasniç Saraçi, Berat Maloku, Aziz Emini dhe Adem Hoti, anëtarë të komitetit.

Mungoi: Zdravko Zdravković (kryesues).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it sloven, OSBE-së, Aktere Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Në mungesë të kryesuesit të komitetit, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Gresa Muli, anëtare e Komitetit për Komunitete, e cila konstatoi se ekziston shumica për punë.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim i hapur për gjendjen ekologjike në territorin e komunës së Vushtrrisë;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Diskutim i hapur për gjendjen ekologjike në territorin e komunës së Vushtrrisë.

Gresa Muli, anëtare e komitetit – desha të informohem se çka po ndodhë me disa deponi ilegale të mbeturinave që kanë qenë në vendet ku jetojnë komunitetet joshumicë. Pasi që nuk kemi ndonjë zyrtar kompetent apo udhëheqësin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, nuk e di se kush do më jap përgjigje.

deponi ilegale dhe hudhen shumë mbeturina. E kam lajmëruar një kohë komunën dhe e kanë pastruar. Por, hudhja e mbeturinave po përsëritet vazhdimisht. Disa herë e kam lajmëruar këtë rast në polici, por policia na ka thënë që t'i fotografoni në mënyrë që të kemi dëshmi. Kur ta kisha bërë këtë veprim, kjo do të thotë që unë jam polic. Unë nuk jam polic dhe nuk e bëj këtë veprim, sepse çdokush duhet ta kryej punën e vet.

Gresa Muli, anëtare e komitetit – nëse fotografitë janë ndihmë për ta zgjidhur problemin, pse mos me i fotografu dhe me i raportu rastet.

Aziz Emini, anëtar i komitetit – nëse i fotoj, atëherë po hyj në konflikt me njerëzit dhe nuk dua të më gjykoj dikush për këtë veprim.

Gresa Muli, anëtare e komitetit – pajtohem, por duhet të gjendet ndonjë zgjidhje.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – ky problem ka qenë edhe vitin e kaluar, ku është thënë që në Prelluzhë s'po kemi me çka me i heq mbeturinat. Ju kam thënë edhe vitin e kaluar, po ju them edhe tash se çka të ju nevojitet na thirrni dhe jemi të gatshëm t'ju ofrojmë ndihmë. Ju pata thënë që një shok e ka një traktor me rimorkio dhe kam qenë i gatshëm ta sjelli për ta zgjidhur problemin. Por, banorët janë ata që duhet të shprehin gatishmëri për pastrimin e mbeturinave. Ndjej keqardhje për këtë problem që është që disa vite. Prandaj, prapë po them që unë jam i gatshëm për t'ju ndihmuar.

3. Të ndryshme.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – tha se në fund të tetorit ose nëntorit do të mbahen zgjedhjet komunale. Pasi që e kemi mundësinë t'i mbajmë 12 mbledhje në vit, atëherë t'i mbajmë nga 2 mbledhje në muaj, në mënyrë që dy muajt e fundit mos të vijmë fare.

Bujar Klinaku, sekretaria e kuvendit – deklaroi se mbledhjet e komitetit janë të planifikuara që të mbahen çdo muaj. Andaj, është problem që të realizohen pagesat e mëditjeve nëse nuk mbahen ashtu siç janë planifikuar.

Mbledhja përfundoi në ora 11:05.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës

